

UDHËZIM
Nr. 764, datë 2.11.2018

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 542, DATË 21.7.2010,
“KRITERET SPECIFIKE QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET E
SPECIALIZUARA PËR PAJISJEN ME AUTORIZIM PËR PËRDORIM CIVIL
TË LËNDËVE PLASËSE”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorim civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të pikës 2b, 4a dhe 7b, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 5.5.2010, “Për procedurën e dhënies së autorizimit të përdorimit civil të lëndëve plasëse”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 542, datë 21.7.2010, “Për kriteret specifike që duhet të plotësojnë subjektet e specializuara për pajisjen me autorizim për përdorim civil të lëndëve plasëse”, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas pikës I, të shtohet pika I/I, me përbërje si më poshtë:

“I/I Subjektet e licencuara në fushën hidrokarbure dhe të cilat për realizimin e veprimtarisë së tyre e kanë të domosdoshme përdorimin e lëndëve plasëse, mund të kryejnë këto operacione me anë të kontraktimit me subjekteve e specializuara të autorizuar për përdorim të lëndëve plasëse në fushën e veprimtarisë së tyre. Subjektet e specializuara, të cilët kërkojnë që të pajisjen me autorizim “Për përdorim civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë”, për kryerjen e operacioneve hidrokarbure, në përputhje me kërkesat e ligjit 7746/1993, “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhim)”, të ndryshuar, duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 315, datë 5.5.2010, si dhe kriteret specifike si më poshtë:

1. Të dhëna të përgjithshme për personelin inxhiniero-teknik të kualifikuar nga ana profesionale për të cilin kërkohet:

a) Personelin inxhiniero-teknik duhet të ketë njohuri dhe të ketë realizuar veprimtari të mëparshme në kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

b) Kontratë punë e noterizuar me drejtuesin teknik, për punët me lëndë plasëse, si dhe fotokopjen e noterizuar të diplomës së drejtuesit teknik, i cili duhet të ketë certifikatën e lejes profesionale të tipit A5, dhënë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 18.6.2015, “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, tran-sportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”.

c) Kontratë punë me zjarrmëtarin dhe fotokopjen e noterizuar të dëshmisë së tij.

ç) Kontratë për sigurimin e punonjësve, të punësuar në veprimtarinë përkatëse.

2. Personeli inxhiniero-teknik duhet të jetë i aftë nga gjendja shëndetësore për të kryer aktivitet me lëndë plasëse nëntoke e sipërfaqe.

3. Personeli inxhiniero-teknik duhet të ketë vendbanim në Republikën e Shqipërisë.

4. Subjekti i interesuar duhet të ketë pajisjet teknike-teknologjike për kontrollin teknik dhe shpërthimin e ngarkesave me lëndë plasëse, në përputhje me natyrën e tyre.

5. Personeli inxhiniero teknik nuk duhet të ketë kryer vepra penale.

6. Autorizimi për përdorim civil të lëndës plasëse i jepet subjektit të interesuar në emër të drejtuesit teknik.”.

2. Pika II, për “Kushtet që duhet të plotësojë stafi teknik dhe specialistët e huaj”, të ndryshojë si më poshtë:

“a) Duhet të jenë me banim në Republikën e Shqipërisë.

- b) Duhet të ketë leje qëndrimi në Republikën e Shqipërisë.
 - c) Duhet të ketë leje punësimi në Republikën e Shqipërisë, sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.
 - d) Duhet të jenë të aftë nga gjendja shëndetësore për të kryer aktivitet me lëndë plasëse nëntokë e sipërfaqe.
 - e) Nuk duhet të ketë kryer vepër penale.
 - f) Duhet të jenë të pajisur me diplomë të inxhinierit të minierës ose të industrisë së hidrokarbureve, si dhe të kenë eksperiencë pune nëntokë apo në industrinë e hidrokarbureve minimalisht 3 vjet.
 - g) Duhet të jenë të licencuar nga AKBN-ja, “Në projektim, vlerësim, konsulencë, monitorim dhe zbatim (drejtim teknik) në fushën e shfrytëzimit të veprimtarisë minerare në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 966, datë 2.7.2009 apo sipas kërkesave të nenit 13/4, të ligjit 7746/1993 dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 18.6.2015.
 - h) I gjithë dokumentacioni duhet në gjuhën shqipe ose i përkthyer dhe i noterizuar.”.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjilknuri